



Pranuar / Doretuar Priljevendit/Priljevendit Received/Delivery	06.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBIK	3963/2022		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.472/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1847/2021 të datës 11.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.472/2021 të datës 01.06.2022, të parashtruar nga grup ankuesish

cilit me autorizim i përfaqëson avokat

me adresë

kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit, në çështjen juridike "Kompensim Material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.472/2021 e datës 01.06.2021 e parashtruar nga ankuesit

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për kompensimin e orëve të punës për ankuesit, sipas formularëve të plotësuar dhe aprovuar nga menaxheri drejtues, dhe Vendimit Nr.312/2021 të datës 12.04.2021.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.



## A r s y e t i m

Ankuesit [redacted] që të gjithë të punësuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me datë 31.05.2021, përmes postes elektronike kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e cila ankesë me datë 01.06.2021 është regjistruar me numër protokollit 2763/2021 dhe ka marr shenjen A.nr.472/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka mundur të shqyrtoj ankesën e ankuesve si me lartë dhe te njëjtit me datë 12.07.2021 janë udhëzuar për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.nr.1847/2021 të datës 11.05.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, tani ankuesve, dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën A.nr.472/2021 të datës 01.06.2021.

*Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër A.nr.472/2021 të datës 01.06.2021 të parashtruar nga ankuesit [redacted]

Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.06.2021 me numër të protokollit 2974/2021; Përgjigjen në ankesë të datës 22.07.2021 me numër të protokollit 3842/20212; Kërkesën e datës 12.04.2021 me numër 1097/2021 lidhur me disponushmerin e mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve: Emailin e datës 29.06.202; 30.04.2021; 30.04.2021; Akt emërimit e datës 31.10.2012 me numër 2540/2012; Akt emërimit e datës 25.07.2014 me numër të protokollit 3117/2012; Akt emërimit e datës 10.06.2021 me numër të protokollit 2620/2014; Akt emërimit e datës 25.07.2014 me numër të protokollit 3223/2012; Akt emërimit e datës 19.05.2020 me numër të protokollit 1623/2020/02; Vendimin me numër 1088/2021-2 te datës 12.04.2021; Formularët për punë shtesë të ankuesve; Tabelën lidhur me analizën në kategorinë paga dhe mëditje prill 2021; Raportin përmbledhës i kontrollit të buxhetit për vitin 2021; Vendimin me numër të protokollit 2807/2019/02 të datës 10.07.2019; Raportin për javën evropiane të sportit të datës 31.10.2019; Kërkesën e datës 12.04.2021 për pagese retroaktive të ankuesve; Kontratën e punës për marrëveshje të shërbimeve të veçanta të datës 25.10.2018 me numër të protokollit 3758/2018-22; Kontratën e punës për marrëveshje të shërbimeve të veçanta të datës 14.07.2017 me numër të protokollit 3186/2047; Emalin e datës 09.07.2021; Parashtresën me numër të protokollit 3765/2022 të datës 28.06.2022; Autorizimin lidhur me përfaqësimin e ankuesve të vitit 2019; Autorizimin e datës 11.08.2021; Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës me numër të protokollit 3652/2021 të datës 12.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesve, *është e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), dhe atë [redacted] është i punësuar në pozitën e punës



"Menaxher i TI-së", [redacted] në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun", [redacted] në pozitën "Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativë", [redacted] në pozitën "Zyrtare i IT-së" dhe [redacted] në pozitën "Zyrtar për administrimin e Teknologjisë Informativë".

Ankuesit, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kërkojnë që t'iu njihet e drejta e kompensimit të pagesës për punë jashtë orarit të rregullt, duke ju referuar Vendimit Nr.1299/2019 të datës 09.07.2019, Vendimit Nr.312/2021 të datës 12.04.2021, si dhe formularëve për punë shtesë të plotësuar dhe aprovuar nga menaxheri drejtues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve ka analizuar shkresat e lëndës dhe rrjedhimisht ka gjetur se me Vendimin Nr.1299/2019 të datës 09.07.2019 është emëruar ekipi punues për hartimin e strategjisë lidhur me Javën Evropiane të Sportit për vitin 2019. Sipas këtij vendim ekipi punues është përbë nga [redacted]

Kolegji i Këshillit, po ashtu bazuar në shkresa të lëndës, gjegjësisht formularët për punë shtesë të aprovuar nga menaxheri drejtues, ka gjetur se ankuesit si pjesë e ekipit për hartimin e strategjisë lidhur me Javën Evropiane të Sportit për vitin 2019, kanë punuar edhe jashtë orarit të rregullt të punës, dhe rrjedhimisht me Vendimin Nr.312/2021 të datës 12.04.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, ankuesve ju është lejuar kompensimi i pagesës për punë jashtë orarit të rregullt, si në vijim: [redacted] 720 euro, [redacted] 655.2 euro, [redacted] 720 euro, [redacted] 655.2 euro, dhe [redacted] 590.4 euro.

Kolegji i Këshillit, duke ju referuar legjislacionit të aplikueshëm lidhur me çështjen e kompensimit të nëpunësve civil, respektivisht dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 21 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim me pagesë për punë jashtë orarit ose kohë të lirë kur institucioni punëdhënës kërkon nga ta që të punojnë jashtë orarit, në rrethanat e përcaktuara me Ligjin e Shërbimit Civil, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 11 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Në pajtim me Nenin 21 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësit kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit, me pagesë ose me kohë të lirë. 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë për punën jashtë orarit, nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën jashtë orarit, dhe pas konstatimit se ankuesit me Vendimin Nr.1299/2019 të datës 09.07.2019 të Zyrtarit Kryesor Administrativ kanë qenë të emëruar në ekipin punues për hartimin e strategjisë lidhur me Javën Evropiane të Sportit për vitin 2019, dhe të njëjtit punën jashtë orarit e kane dëshmuar me formularët e plotësuar dhe të aprovuar nga menaxheri drejtues, konstaton se pretendimi ankimor i ankuesve për kompensimin e orëve të punës jashtë orarit të rregullt, është i bazuar.

Andaj, bazuar si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se organi i punësimit, gjegjësisht Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është i obliguar që të ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme për procedimin e pagesës për kompensimin e orëve



të punës për ankuesit, sipas Vendimit Nr.312/2021 të datës 12.04.2021 dhe formularëve të plotësuar dhe aprovuar nga menaxheri drejtues.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.472/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Arkivat të KPMSHCK- së;

